

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta – Ministry of Culture, Youth and Sport

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I LIDHUR

NDËRMJET

MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

DHE

KOMUNËS SË GJAKOVËS

1. QËLLIMI I MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit (MB) është mbështetja financiare për projektin: **“Renovimi i Stadiumi të Qytetit në Gjakovë”** që do të implementohet gjatë viteve 2019/2020/2021.

2. AUTORITETET

Qëllim i Memorandumi do të përmbushet nga:

2.1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; dhe

2.2. Komuna e Gjakovës.

(në tekstin e mëtejshëm: Palët)

3. OBLIGIMET E PALËVE

3.1. OBLIGIMET E MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT (më tutje MKRS)

MKRS-ja, sa i përket qëllimit të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, merr përsipër këto obligime si në vijim:

3.1.1. Investon mjetet financiare në vlerë prej 1,300,000.00 € (një milion e treqind mijë euro) për projektin: “Renovimi i Stadiumi të Qytetit në Gjakovë” e përcaktuar si në pikën një (1) të këtij Memorandumi;

3.1.2. Mjetet financiare si më lartë, MKRS do t'i ndajë në periudhat kohore si më poshtë:

3.1.2.1. 400,000.00 € (katërqind mijë euro) do të shpenzohen gjatë vitit 2019;

3.1.2.2. 400,000.00 € (katërqind mijë euro) do të shpenzohen gjatë vitit 2020;

3.1.2.3. 500,000.00 € (pesëqind mijë euro) do të shpenzohen gjatë vitit 2021.

3.1.3. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me kërkesë të KK. Gjakovës, cakton një Zyrtar si organ mbikëqyrës për monitorimin e kontratës me Vendim përkatës për implementimin e projektit;

3.1.4. Merr përsipër menaxhimin dhe zhvillimin e të gjithave procedurave të prokurimit, për zbatimin e këtij memorandumi dhe arritjes së qëllimit të tij;

3.1.5. Në bashkëpunim me Komunën e Gjakovës, kujdesen për implementimin e projektit.

3.2. OBLIGIMET E KOMUNËS SË GJAKOVËS

Komuna e Gjakovës merr përsipër këto obligime sa i përket qëllimit të këtij Memorandumi, si në vijim:

- 3.2.1. Në bashkëpunim me MKRS-në kujdesen për implementimin e projektit në fjalë.
- 3.2.2. Merr përsipër hartimin e projektit si në pikën një (1) të këtij Memorandumi.

4. ZBATIMI

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me Komunën e Gjakovës e përcjellin zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe udhëzojnë për veprimet që duhet të ndërmerren në implementimin e obligimeve në mbarëvajtjen e punimeve, deri në momentin e realizimit të qëllimit.

5. MUNDËSIA E NDËRPRERJES SË MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT DHE RRETHANAT E PAPARASHIKUARA

5.1. Ndërprerja e Memorandumit të Bashkëpunimit bëhet më marrëveshje ndërmjet palëve;

5.2. Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të ndodhjeve të Fuqisë mbinatyrore – Vis major dhe rrethanave tjera të pa parashikuara, palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim me palët tjera relevante për veprimet që duhet të ndërmerren.

6. AFATI I REALIZIMIT

Afati i realizimit të qëllimit të Memorandumit të Bashkëpunimit duhet të arrihet brenda viteve 2019/2020/2021.

7. AMANDAMENTIMI

Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndryshoj apo plotësohet sipas një Marrëveshje me shkrim midis palëve. Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë MB, për të cilat palët do të pajtohen për të hyrë në MB në të ardhmen, apo në një amendament të këtij MB-je, të nënshkruar nga palët e kësaj Marrëveshje do të konsiderohen si të integruara në këtë dokument.

8. ZGJIDHJA NË RAST TË MOSMARRËVESHJEVE

Palët do të përpiqen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, atëherë në rast të mosmarrëveshjes, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë që ka kompetencë të zgjidh rastet e tilla.

9. KOPJET DHE GJUHËT E MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT



Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Secila palë do ta ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.

10. HYRJA NË FUQI

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.

Kujtim GASHI,

Ministër i Ministrisë së
Kulturës, Rritjes dhe Sportit



Ardian Gjini,

Kryetar i Komunës së Gjakovës



Nënshkruar më 15/05/2019
Prishtinë